



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga Procesverbali i mbajtur më 01 prill 2020, në mbledhjen e XXIII-të (njëzet e tretë), e jashtëzakonshme, mandati VI, të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, kati përdhës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Mehmet Gashi, Arlinda Kadriu, Avni Fetahu, Fatlume Jaha, Adelinë Stublla, me përjashtim të z.Rafet Llapashtica i cili mungoi *si dhe dy anëtarëve, Floretë Zejnullahu dhe Fitim Haziri të cilët janë zgjedhë Deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës.*

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin; Isuf Latifi, Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave – DBF, Faik Muçiqi, Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit – DSHPMSh, Agim Blakçori, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit – DKA, Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës – DA, Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit – DI, Zaim Thaqi, Drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale – DSHMS, Mirsad Kamerolli, Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik – DPZHE,

Rendi i ditës

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i falënderuar të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje në këtë kohë dhe situatë të krijuar nga Pandemia Corona Virusi COVID-19.

I njoftoj rreth rendit të ditës dhe kërkesës së Nënkryetarit të Komunës z.Nexhmi Rudari, për thirrjen e kësaj seance, dhe shtoi, thirrjen dhe materialin për këtë seancë të jashtëzakonshme besoj se e keni marrë të gjithë, me përjashtim të anëtarit z.Rafet Llapashtica me të cilin sapo bisedova përmes telefonit nga i cili u informova se përveç thirrjes për seancën e Kuvendit që do të mbahet nesër, nuk ka marrë thirrje për këtë mbledhje të KPF-së, por që potencoi se, meqë jemi në një situatë të tillë konsideroj se është mirë të merret parasysh edhe deklarimi im përmes sms – mesazhit nga distanca rreth qëndrimit të Grupit të këshilltarëve të PDK-së lidhur me këtë seancë, përkatësisht rendit të propozuar të ditës.

(Gjatë kohës sa po mbahej mbledhja, deklarimi i z.Rafet Llapashticës përmes sms-mesazhit ishte si në vijim: “Përshëndetje Kryesues, i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim të pikave të rendit të ditës të rekomanduara për seancën e Kuvendit e cila do të mbahet më datë 02.04.2020”).

Sigurisht jeni në dijeni se në mbledhje të jashtëzakonshme nuk mund të plotësohet apo ndryshohet rendi i ditës, mirëpo meqë bëhet fjalë për një situatë jo normale të krijuar, dhe kërkohet kontribut nga të gjithë, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën para se të kalojmë me rendin e ditës sipas kësaj thirrje.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, theksoi, fillimisht ju dëshiroj shëndete të mirë të gjithë atyre që janë prekur nga Corona Virus – COVID-19, duke u lutur që sa më pak të ketë të prekur dhe ta kalojmë këtë me sa më pak pasoja.

Për hir të kësaj situatë pandemie është thirr edhe kjo seancë e jashtëzakonshme me tri propozim vendime, përkatësisht; 1-për ndarjen e shumës financiare prej 125,000.00€ për t'i ndihmuar qytetarët në nevojë, mjete këto të cilat janë marrë nga: Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, dhe të cilat janë të disponueshme dhe që mundemi të procedojmë menjëherë, propozim i cili do të ishte mirë të plotësohej si vijon, në fund të nenit 1 të shtohet edhe fjalia “*për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Corona Virus – COVID-19*”, si dhe në paragrafin 2 të nenit 2, pas fjalës *Kompensohen*, të plotësohet me “*Drejtorive përkatëse*” dhe të vazhdoj ashtu siç është. Pra kjo për shkak se për hir të situatës në fjalë, ende nuk kemi arritur të procedojmë propozimin për bartjen e të hyrave të pashpenzuara në vitin 2019 në vitin 2020, andaj duke pas parasysh se këto mjete që janë propozuar për këtë qëllim janë të disponueshme, atëherë kemi vendos që këtë kompensim të mjeteve, ndoshta edhe me rritjen e shumave sipas mundësive, t’ju kthehen/barten sërish Drejtorive përkatëse me një vendim tjetër. Pra të mos ketë keqkuptime kinse këto mjete po merren nga sektor të caktuar dhe po barten në këtë fond, por këto mjetet merren përkohësisht e që do të plotësohen sërish me një vendim tjetër.

Pastaj kemi, 3-propozim vendimin për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës Komunale për vitin 2020, e që i cili po ashtu përmban një lëshim teknik do të thoja, konkretisht në nenin 2, ku thuhet “*lirim nga taksa*”, të korrigjohet si vijon, “*lirimi nga pagesa e qirasë*”. Po ashtu janë edhe disa gabime teknike-gjuhësore të cilat do të ishte mirë të korrigjoheshin ngase vërtetë këto dokumente janë përgatitur për një kohë shumë të shkurtër dhe natyrisht mund të jenë lëshua gabime.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, pra kemi një sqarim të cilin e bëri Drejtori parafolës rreth shumës së propozuar si dhe për disa gabime teknike, për çka e falënderoj.

z.Avni Fetahu, theksoi, do të ishte mirë të sqarohemi para se të votojmë për këtë rend dite dhe pikat përkatëse. Lidhur me propozim vendim e parë, po nënkuptohet se mjetet financiare janë marrë nga Drejtoritë në fjalë sipas propozim vendimit, mirëpo me këtë bartje nuk po del e kuptueshme shumë se çka synohet të bëhet pastaj, të paktën unë këtë variantin siç e sqaroj Drejtori parafolës nuk po e kuptoj. Pra për kompensimin e atyre projekteve, nga ku do të merren mjetet buxhetore dhe nga cili fond.

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, përgjigje parafolësit, theksoi, mjetet e pashpenzuara në vitin paraprak si gjithë herë barten në vitin aktual, në këtë rast nga vitit 2019 në vitin 2020, e të cilat pa pasur një vendim të Kuvendit nuk janë të disponueshme për Komunën. Duke pas parasysh se ato mjete janë të predisponueshme për projekte të cilat kanë mbet në gjysmë, e që në bazë të një analize që kemi bërë ka shumë pak borgje në projektet e vitit të kaluar, dhe kjo pjesë e mjeteve pa asnjë problem mund të destinohet për kompensimin e Drejtorive përkatëse, përkatësisht për ato projekte të atyre Drejtorive.

kemi marrë një qarkore nga Ministria e Financave sipas të cilës automatikisht lejohet të bëjmë ridestininim përkatësisht transfer të mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale në kategorinë e subvencioneve, mirëpo duke marrë parasysh që kjo shumë e propozuar, janë mjetet ende të lira është më e favorshme që tani për tani të ndahen sipas propozim vendimit, e pastaj të kompensohen ato shuma në ato Drejtori, nga mjetet e pa shpenzuara në vitin 2019.

Pra ky fond është i disponueshëm, por pa një vendim të Kuvendit nuk mund të përdoren, por që shpresoj që në seancën e radhës kjo çështje do të rregullohet, përkatësisht do t’iu kthehen mjetet Drejtorive përkatëse, ndoshta edhe me rritje të shumave varësisht mundësive.

Vlen të theksohet se ne kemi mundësi qysh tani që 5% të investimeve kapitale ta transferojmë në kategorinë e subvencioneve dhe varësisht në kategorinë mallra dhe shërbime, mirëpo këtë herë ka qenë më se e nevojshme dhe më se e arsyeshme që kjo çështje të bëhet në këtë formë siç kemi propozuar.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, paraprakisht falënderoj parafolësit, mirëpo në raste të tilla gjithë herë fillimisht duhet të miratohet rendi i ditës, pastaj të hapet një diskutim i tillë. Si do qoftë, a jeni për këtë rend dite me pikat e propozuara sipas thirrjes dhe materialit të kësaj mbledhje, dhe atë:

Pas diskutimeve dhe sqarimeve të nevojshme, njëzëri nga anëtarët e KPF-së u mbështet që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, me plotësim ndryshimet për shkak të lëshimeve teknike, dhe atë:

-Në propozim vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 125,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike, në nenin 1, tekstit përkatës i shtohet, (.... për shkak të situatës së krijuar nga Pandemia Corona Virus COVID-19).

Në paragrafin 2 të nenit 2, pas, t'iu kompensohen, i shtohet teksti Drejtorive përkatëse.....

*-Në propozim vendimin për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës Komunale për vitin 2020, në nenin 2 ku thuhet, lirimi nga taksa, të fshihet dhe të zëvendësohet me, **lirimi nga pagesa e qirasë....***

(Vlen të theksohet se anëtarët e subjektit i LVV-së, edhe për kundër votimit, për, kërkuan që të potencohet se Propozim Vendimin për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 125,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike, e përkrahin dhe e konsiderojnë të mirëseardhur, por që kanë vërejtje që nuk do të duhej të përmbante diçka që do të vie më vonë, si dhe vërejtjen tjetër që pikat në fjalë do të duhej të shqyrtoheshin ndaras sepse në këtë formë krijohen paqartësi tek këshilltarët e Kuvendit)

➤ **Masat për parandalimin dhe luftimin e Corona Virusit COVID-19**

- **Propozim vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumë 125,000.00€, ndihmë qytetarëve në nevojë me pako ushqimore dhe hixhienike.**
- **Propozimi i vendimit për lirimin nga taksa komunale e të gjitha Subjekteve afariste që ushtrojnë veprimtari në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2020**
- **Propozimi i vendimit për lirim nga pagesa e qirasë për të gjithë shfrytëzuesit e pronës Komunale për vitin 2020**

z.Mehmet Gashi, theksoi, sigurisht që të gjithë ne jemi në dijeni rreth situatës së krijuar nga COVID-19 dhe që shumica prej Komunave kanë miratuar vendime të tilla duke ndarë mjete në shuma të ndryshme. Shpresoj se ne ndoshta nuk do të kemi nevojë të ndajmë mjete nga kategoria e investimeve kapitale sepse kemi një buxhet nga të hyrat vetanake në vitin 2019 e të cilat sipas një vendimi do të barten në vitin 2020, kështu që këto mjete mund t'i bartim dhe t'i kompensojmë pastaj.

Unë i përkrahi plotësisht të tri propozim vendimet në fjalë, me theks propozim vendimin për ndarje të mjeteve me synim që në rast se paraqitet nevojë të ndajmë sërish shumë tjetër financiare sepse vërtetë ka nevojë të ndihmohen familje të cilat kanë nevojë për ndihma. Pra në emër të Grupit të këshilltarëve të LDK-së e përkrahim pa asnjë vërejtje.

z.Avni Fetahu, në emër të grupit të LVV-së theksoi, fillimisht do të kishim dëshirë, për të mos u krijuar një situatë jo e kuptueshme edhe për qytetarët nesër në mbledhjen e Kuvendit, do të ishte mirë që këto pika një nga një të propozoheshin. Jo që ka diçka kundër tyre por mund të ketë sugjerime për diçka të tillë dhe mund të krijohet një përshtypje sikurse nuk ka gatishmëri për tu përkrahur e që kjo është më se e nevojshme, e mirëseardhur dhe nuk ka asnjë diskutim për këtë, mirëpo do të ishte mirë që propozimet

të vinin një nga një për tu diskutuar dhe për të ardh deri tek miratimi, por kështu si është propozuar në formë të pakos do ta vështirëson punën paksa, do ta zgjat debatin e që nuk është i nevojshëm të zgjatet, kështu që është propozim i joni në mënyrë që të menaxhohet situata më mirë nesër, të shkohet pikë për pikë, dhe të miratohet për arsye se ka çështje rreth qirasë, taksës të cilat fakt që ndërlidhen me këtë, por nuk mund ta krahasosh me një shumë financiare prej 125,000.00€ e cila është shumë jetike dhe e domosdoshme për popullatën si ndihmë me mjetet ushqimore dhe hixhienike.

Pra ky është propozim i joni si LVV, por ju vlerësojeni sërish.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, në seanca të jashtëzakonshme parashihen edhe pikat e rendit të ditës dhe ato nuk mund të ndryshohen apo plotësohen, në këtë aspekt rendi i ditës është përcaktuar, thirrja dhe materiali është dërguar, të gjithë jemi të informuar dhe vetëm mundemi të rekomandojmë, mirëpo unë besoj se për këto tri çështje që janë në kuadër të kësaj pike do të ketë mundësi dhe do të debatohet dhe nuk shohë ndonjë problem në këtë aspekt sepse do të kenë mundësinë dhe rastin secili prej këshilltarëve të Kuvendit të marrin fjalën, të japin mendimet e tyre në mënyrë që të vijmë deri tek ajo që është më e mira për qytetarët dhe për të gjithë neve rreth kësaj situatë të krijuar, pra ky është mendimi im.

znj.Fatlume Jaha, theksoi, natyrisht se i bashkëngjitem asaj që u tha në emër të Grupit të LDK-së ngase përçohet mesazhi tek qytetarët se nëse ka nevojë dhe mundësi për tejkalimin e kësaj situatë për të cilën po kalojmë dhe për të cilin mund të themi se nuk e kemi pritur një situatë të tillë dhe kjo tregon edhe me vetë faktin që po mbajmë sot një mbledhje të tillë në këto rrethana.

Po ashtu do të doja të merremi edhe me çështjen e fshatit Dumnice i cili është futur në karantinë, gjë për të cilën unë e përcjella një deklaratë të Nënkryetarit të Komunës i cili e tha se ai fshat do të dal nga karantina, andaj nuk jam në dijeni se a është marrë një vendim i tillë ende apo jo, mirëpo do të ishte mirë që atë fshat, përfshirë edhe fshatrat tjera përreth, në kuadër të kësaj ndihme që është propozuar, edhe pse jam në dijeni se deri tani janë shpërndarë ndihma, do të ishte mirë që ta trajtojmë në mënyrë të veçantë për shkak se ashtu siç mund edhe ta imagjinojmë, të jesh i izoluar dhe të mos mund të furnizohesh me gjëra më elementare nuk është mirë ta lëm një gjë të tillë dhe pse e di se nuk ka pasë stagnim në këtë drejtim. Pra duke shpresuar se nuk do të kemi edhe fshatra apo lagje tjera që do të jen në këtë situatë, do të ishte mirë që komisioni përkatës i formuar për këtë çështje të rishikoj këto pika që janë më të ndjeshme dhe ku pamundësia për të arritur deri tek çështjet dhe gjërat më elementare është më e vështirë. Përveç çështjeve që i ceku Drejtori i DBF tek aspekti teknik, ndoshta meqë OBSH-ja e ka cilësuar si Pandemi, do të ishte mirë që edhe në dokumentet zyrtare edhe ne ta cilësojmë si Pandemi, kjo ngase kam vërejtur se gjatë gjithë kohës ishte cilësuar si Epidemi. Nuk është se unë marrë vesh shumë në terme mjekësore por sa pash Pandemia kishte edhe atë kuptimin e shtrirjes së tërësishme gjeografike të Epidemisë, prandaj meqë jemi institucion ndoshta do të ishte mirë që edhe ne ta cilësojmë Pandemi ashtu siç e ka cilësuar edhe OBSH.

E përshëndes shumë iniciativën për thirrjen e një seance të tillë edhe pse mendoj se nuk është e lehtë as për ju as për ne që të rrezikojmë dhe të vijmë këtu, por mbi të gjitha, para së gjithash është interesi i qytetarëve sepse ne nuk mund të rrimë duarkryq dhe qytetarët ndoshta të mos kenë gjëra elementare ushqimore, dhe në këtë aspekt do të falënderoja gjithë kolegët e Grupit të LDK-së me të cilës vazhdimisht kemi diskutuar dhe i kemi qarë hallet edhe me Kryesuesin e Kuvendit, andaj edhe kemi qenë shumë pro, për thirrjen e një seance të tillë për t'ju dal në ndihmë qytetarëve.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, sa i përket vënies në karantinë janë masa të cilat janë marrë në koordinim me shtabin emergjent i cili është i krijuar me kohë në Komunën e Podujevës, dhe sa unë di çështja e vënies në karantinë varet nga niveli qendrorë, jo nga niveli lokal, por duhet të shikohen arsyet dhe të merren vendime të duhura për këtë kohë e që ndërlidhen me qytetarë të atyre fshatrave.

Sa i përket emërimit, ne jemi në dijeni që kjo situatë veç ka kaluar në Pandemi ngase Epidemi është vetëm për një shtet, pastaj kur kemi të bëjmë me vetëm një regjion është Endemi, kurse kur shtrihet në pjesën më të madhe të rruzullit tokësor është Pandemi, kështu që nuk është diçka e madhe kjo por është e arsyeshme të korrigjohet termi Epidemi me Pandemi.

z.Mirsad Kamerolli, drejtor i DPZHE, theksoi, propozim vendimi për lirim nga taksa komunale, besoj se është simbolik por megjithatë jemi të gjithë të vetëdijshëm se kjo gjendje kërkon shumë më shumë dhe po shpresoj se pas vendimit të marrë edhe nga ana e Qeverisë do të bëhen edhe ndihma tjera për sektorin privat sepse jemi në dijeni se janë duke u përballur me një gjendje të vështirë sa i përket operimit të tyre sepse edhe në lokalitete të vogla operimi i tyre ka qenë shumë simbolik, sa për mbijetesë, por kjo periudhë kohore e ka vështirësuar edhe më shumë, andaj mendoj se ne duhet të mundohemi që në kuadër të mundësive dhe kapaciteteve që kemi t'iu dalim në ndihmë atyre në mënyrë që t'ju zgjatim funksionalizimin e tyre tani dhe pas kthimit në gjendje normale pas daljes nga kjo situatë Epidemike që jemi.

Shpresoj se në të ardhmen do të kemi raporte pozitive nga terreni dhe vendimet e Qeverisë dhe ato të Komunës vërtetë do të jenë vendime të cilat do të kenë efekte pozitive.

z.Zaim Thaqi, drejtor i DSHMS, theksoi, temat tona si profesionist shëndetësor nuk janë edhe aq të mira për tu diskutuar, por nganjëherë është edhe privilegj për t'iu gjinde njerëzve pran kur kanë nevojë në situata të tilla siç jemi sepse edhe vetë misioni i punëtorëve shëndetësorë është i tillë, duke përfshirë edhe gjithë të tjerët që janë duke kontribuar në këtë situatë që jemi.

Nuk dëshiroj të ndalem në pika të veçanta se çfarë kemi bërë deri tani, por mund t'ju informoj se jemi duke bërë punën më të mirë të mundshme po mendoj. Kemi themeluar Shtabin Komunal për Emergjencë dhe kemi komunikim 24 orë mes anëtarëve të shtabit e që është një gjithë përfshirje e të gjitha institucioneve të cilat mund të kontribuojnë më së shumti në këtë periudhë dhe në këtë aspekt jemi në kontakt të vazhdueshëm me gjithë akterët relevant në mënyrë që situatën ta mbajmë nën kontroll. Mendoj që gjitha iniciativat, harmonizimi i veprimeve dhe gjitha këto aktivitete të derisotshme dhe që do të vazhdojnë në të ardhmen shpresoj që kanë ndikuar pozitivisht në situatën epidemiologjike që kemi sot në Komunën tonë, situatë kjo e cila nuk mund të nënvlerësohet sepse është e qetë, stabile dhe nën kontroll.

Jeni në dijeni se në fillim kemi qenë të atakuar ashtu siç ka ndodh edhe në Komunitet tjera, por falë angazhimit, përkushtimit dhe profesionalizmit që për fat të mirë kemi profesionistë të fushës në institucionet tona shëndetësore si dhe harmonizimi dhe gatishmëria brenda përbrenda Komunës dhe Drejtorive për të bërë edhe rrethana lehtësuese ekskluzivisht në kuptimin e furnizimit me pajisje mbrojtëse parandaluese, andaj në një situatë të tillë unë mendoj se nuk duhet të fokusohemi në pika tjera përveç pikës së parë që ndërlidhet me furnizime si dhe dy pikave tjera që janë rrethana lehtësuese në këtë situatë epidemiologjike që jemi. Sa i përket termit, kjo mund të quhet edhe epidemi, edhe endemi por edhe pandemi, mirëpo tek ne është situatë epidemiologjike, shkencërisht quhet situatë epidemiologjike.

Pra besoj se jemi duke menaxhuar mirë me këtë situatë, natyrisht na nevojitet edhe ndihma e juaj si këshilltar të Kuvendit të Komunës si të gjithë atyre faktorëve që janë relevant në kuptimin e ndryshimeve sa i përket ndarjes së mjeteve buxhetore sepse Komunës respektivisht Drejtorive përkatëse i nevojiten transfere të mjeteve buxhetore mes kategorive të ndryshme buxhetore për të vazhduar menaxhimin e situatës në këtë front që jemi. Nuk po dëshiroj të tingëllojë shumë si optimist, mirëpo ajo që mund ta them është se situatën jemi duke e mbajtur shumë mirë nën kontroll, për të ardhmen nuk di çfarë të them sepse sipas paralajmërimeve na presin javë ndoshta shumë sfiduese, mirëpo në këtë moment jemi duke e mbajtur shumë mirë situatën nën kontroll, gjë për të cilën shumë shqetësim e them se kemi marrë lëvdata të shumta qoftë prej IKSH, prej profesionistëve shëndetësorë që e kanë fjalën

kyçe në këtë situatë, sepse kemi qenë më së mirë të pajisur dhe në nivel të detyrës edhe përkundër asaj që kemi qenë të sfiduar me pikën e kontrollit shëndetësorë në kufi – Merdar, pastaj edhe territori i gjerë gjeografik është një sfidë në vete ngase kemi numër të madh të ambulantave.

Mandej është për tu vlerësuar edhe kontributi i donatorëve të shumtë i cili ka qenë i pa kursyer, mirëpo ndihma e gjithsecilit është e nevojshme në mënyrë që të mbajmë këtë front.

z.Avni Fetahu, theksoi, është mirë të evidentohet në konstatime kjo që po e themi nga LVV, propozimi i par ka ardh prej Nënkryetarit të Komunës, ju keni qenë brenda këtu, keni qenë në hapësira të pa komunikueshme mes vete, ka ardh siç ka ardh ashtu dhe një tentim për të ndryshuar një diçka që do të vie më vonë, për neve është e papranueshme. Edhe pika e dytë për të cilën nesër do të bindeni ngase jeni dëshmitar se shpeshherë asamblistët kanë hyrë në një temë dhe nuk kanë ditë të dalin prej saj por vetëm janë sjellë rreth e rrotull saj, e që do ta vështirësojnë punën paksa, duke pas parasysh edhe minutazhën dhe gjitha të tjerat që kemi në dispozicion sepse nga një informatë e deri tek propozim vendimi për lirim nga qiraja, sigurisht se do ta vështirësojnë punën paksa, andaj edhe të mbeten si vërejtje këto. Natyrisht se ne si Grup i këshilltarëve nga radhët e LVV-së jemi për t'i përkrahur dhe janë të mirëseardhura, mirëpo këto vërejtje të evidentohen.

z.Fatmir Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar të tjerë për të marrë fjalën, konsideroj se diskutimet përfunduan, andaj kush është që t'i rekomandohet Kuvendit për ditën e nesërme kjo pikë e rendit të ditës, përfshirë edhe korrigjimet e cekura nga Drejtori i DBF dhe të tjera të arsyeshme.

Pas votimit, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim, përfshirë edhe korrigjimet e kërkuara nga drejtori i DBF, si dhe korrigjimet e gabimeve teknike dhe gjuhësore.

Kryesuesi i Kuvendit, e konstatoi të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10;40

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr.01-016/01-0020166/20
Podujevë,
01 prill 2020**

**Kryesuesi i Komitetit
Fatmir Gashi**